

SQ


**UDHËZIMET E
PËRDORIMIT
LAVASTOVILJE**

gorenje
BY
ora'ito

Përmbajtja

Paneli përpara	2
Udhëzimet e sigurisë	3
Para se të lani për herë të parë	4
Mbushja e lavastoviljes	5
Përdorimi i lavastoviljes	6
Rregullimet	10
Kujdesi dhe pastrimi	12
Zgjidhja e problemeve	14
Instalimi	18
Shërbimi	21
Informacione për institutin e testimit	21
Informacione teknike	24

Paneli përpara



- | | |
|----------------------------|---------------------------------------|
| 1 Butoni kryesor i ndezjes | 8 Hapje automatike |
| 2 Larje automatike | 9 Higjenë ekstra |
| 3 Larje intensive | 10 Fillim i vonuar |
| 4 Larje ekonomike | 11 Ekrani |
| 5 Larje e shpejtë | 12 Treguesi i solucionit për shkëlqim |
| 6 Shplarje | 13 Treguesi i kripës |
| 7 SpeedWash | 14 Program vetëpastrimi |

Të përgjithshme

- Lexoni udhëzimet e përdorimit dhe ruajini në një vend të sigurt!
- Asnjëherë mos e përdorni lavastoviljen për asnjë qëllim tjetër përveç se për atë që është specifikuar në këto udhëzime përdorimi.
- Mos vendosni asgjë në derën e lavastoviljes ose shportat e lavastoviljes përveç enëve.
- Asnjëherë mos e lini derën e lavastoviljes të hapur pasi dikush mund të rrezohet në të.
- Përdorni vetëm detergjent lavastovileje.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e sipër dhe nga njerëz me aftësi të kufizuara fizike, mendore, kujtesë të dobët ose me mungesë eksperience dhe njohurie. Këta individë duhet të mbikëqyren kur përdorin lavastoviljen ose të kenë udhëzime se si ta përdorin pajisjen dhe të kuptojnë rreziqet që mund të ndodhin. Pastrimi i pajisjes nuk duhet të bëhet nga fëmijët pa u mbikëqyruar.
- Fëmijët duhet të kontrollohen për t'u siguruar që të mos luajnë me lavastoviljen.
- Kabllo të dëmtuar të energjisë duhet të ndërrohen vetëm nga një elektrikist i kualifikuar.
- Përdoreni lavastoviljen vetëm në ambiente shtëpiake për larjen e enëve të shtëpisë. Është i ndaluar çdo lloj përdorimi tjetër.
- Asnjëherë mos futni në lavastovile enë me lëndë holluese brenda për shkak të rrezikut të shpërthimit. Në lavastovile nuk mund të lahen as enët që mund të përmbajnë hi, llak ose lubrifikantë.

PARALAJMËRIM!

Thikat dhe gjërat e tjera me maja duhet të vendosen horizontalisht në shportat e veçanta për thika dhe pirunë.

Montimi

Shikoni pjesën Instalimi.

Siguria e fëmijëve

- Gjithmonë vëreni lavastoviljen në punë sapo të keni hedhur detergjentin.
- Mbajini fëmijët larg nga lavastovila kur dera është e hapur. Mund të mbetet pak detergjent brenda!
- Mos i lini fëmijët ta përdorin ose të luajnë me lavastoviljen. Bëni veçanërisht kujdes kur dera është e hapur.

PARALAJMËRIM!

Fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje – detergjenti i lavastoviles është gërryes!

Ruajtja në dimër/transporti

- Mbajeni lavastoviljen në një vend ku temperatura është mbi pikën e ngrirjes.
- Shmangni transportin për distanca të gjata në mot shumë të ftohtë.
- Transportojeni lavastoviljen në pozicion vertikal ose të shtrirë nga pas.

Funksioni i mbrojtjes nga tejmushja

Mbrojtja nga derdhja mbrapsht fillon të pompojë jashtë pajisjen dhe mbyll hyrjen e ujit nëse niveli i ujit në lavastovile e kalon nivelin normal. Nëse lëshohet mbrojtja nga tejmushja, mbylleni hyrjen e ujit dhe telefononi servisin.

Materiali i paketimit

Paketimi e mbron produktin gjatë transportit. Materiali i paketimit është i riciklueshëm. Ndajini veç materialet e ndryshme të paketimit për të ndihmuar në pakësimin dhe mbetjet e materialeve të lëndës së parë. Shitësi juaj mund t'i marrë paketimet për riciklim ose t'ju drejtojë për të qendra më e afërt e riciklimit. Paketimi është i përbërë nga:

- Karton i rrudhosur i bërë prej 100% materiali të ricikluar.
- Polistiren i fryrë (EPS) pa klor ose fluor të shtuar.
- Përf forcime prej druri të patrajtuar.
- Qese plastike mbrojtëse prej polietilieni (PE).

Hedhja

- Kur lavastovila të ketë arritur në fund të jetëgjatësisë të shërbimit dhe duhet të hidhet, duhet të bëhet menjëherë e papërdorshme. Tërhiqeni kabllin e energjisë dhe priteni sa më shkurt të jetë e mundur.
- Lavastovila është prodhuar dhe klasifikuar për riciklim.
- Kontakttoni me autoritetet lokale për informacione se ku dhe si duhet të riciklohet lavastovila.

Zbutësi i ujit

Për të aritur rezultate të mira larjeje, lavastovilja duhet të ketë ujë të butë (ujë me përbajtje minerale të ulët). Uji i fortë lë një shtresë të bardhë në enë dhe në lavastovilje.

Fortësia e ujit përcaktohet duke përdorur shkallët e mëposhtme: Shkalla gjermane e fortësisë të ujit (°dH) dhe shkalla franceze e fortësisë të ujit (°fH). Një furnizim uji me fortësi më tepër se 6°dH (9°fH) duhet zbutur. Kjo bëhet automatikisht me ndihmën e zbutësit të integruar të ujit. Në mënyrë që zbutësi të funksionojë mirë, duhet të rregullohet sipas fortësisë të hyrjes të ujit.

Kontaktimi me shërbimet e rrjetit të ujit për të kontrolluar fortësinë e ujit në zonën tuaj.

Rregullimi i zbutësit të ujit

Kapitulli Rregullimet në faqen 10 tregon si të rregulloni zbutësin e ujit.

Mbusheni me kripë

Para se të filloni ta përdorni lavastoviljen me zbutës uji, duhet ta mbushni vendin e kripës me kripë në mënyrë që uji të zbutet vetë. Përdorni kripë me kokrra të mëdha ose kripë të posaçme për lavastovilje.


PARALAJMËRIM!

Për të shmangur njollat e ndryshkut, duhet të vihet në punë një program larjeje enësh menjëherë pasi të jetë hedhur kripa.

Asnjëherë mos hidhni detergjent lavastoviljeje në vendin e kripës. Kjo e shkatërron zbutësin e ujit.

Bëni si më poshtë herën e parë:

- 1 Zhvidhoseni kapakun siç tregohet në figurë.
- 2 Vendoseni hinkën e dhënë me lavastoviljen në vrimën e mbushjes me kripë. Në fillim hidhni rreth 1 l ujë.
- 3 Pastaj shtoni kripë, maksimumi 1,5 kg, derisa të mbushet plot.
- 4 Fshijeni kripën e tepërt në mënyrë që kapaku të vidhohet fort.
- 5 Vini në punë një program për t'u siguruar që të shpëlahet kripa në lavastovilje.



Treguesi i rimbushjes me kripë

Kur ka nevojë për të hedhur kripë, ndizet simboli i mësipërm në ekran.


Kur mbaron kripa, zhvidhoseni tapën dhe mbusheni depozitën me kripë. Uji nevojitet vetëm herën e parë! Pastrojeni dhe shtrëngojeni. Vini në punë një program për t'u siguruar që të shpëlahet kripa e derdhur në lavastovilje.

Pas mbushjes, mund të duhet pak kohë para se të fiket simboli.

Mbusheni me solucion shkëlqyes

Tharja bëhet më shpejt dhe arrihen rezultate më të mira nëse përdorni solucion shkëlqyes. Gjithashtu do të arrini rezultate më të mira dhe do të keni enë pa njolla.

- 1 Hapeni kapakun e vendit të solucionit shkëlqyes.
- 2 Mbusheni me kujdes me solucion shkëlqyes. Shtoni solucion shkëlqyes vetëm deri në nivelin e shënuar **max**.
- 3 Fshijini spërkatjet e solucionit shkëlqyes aty pranë.
- 4 Mbylleni kapakun fort.



Treguesi i rimbushjes me solucion shkëlqyes

Kur solucion shkëlqyes të ketë nevojë për të hedhur kripë, ndizet simboli i mësipërm në ekran.

Pas mbushjes, mund të duhet pak kohë para se të fiket simboli.

Rregullimi i dozës të solucionit shkëlqyes

Pjesa Rregullimet tregon si ta rregulloni dozën e solucionit shkëlqyes. Hedhja e solucionit shkëlqyes mund të rregullohet nga 0 (Mbyllur) deri në 5 (Dozë e lartë). (Rregullimi i fabrikës: 5)

Uleni dozën e solucionit shkëlqyes:

- Nëse enët kanë një shtresë ngjyeshë të bardhë/cipë blu.
- Nëse enët janë vija vija.
- Grumbullim shkume. Nëse keni ujë shumë të butë, solucion shkëlqyes mund të hollohet 50:50 me ujë.

Larje enësh me përdorim të efektshëm të energjisë

- Mos e vini lavastoviljen në punë derisa të jetë mbushur plot për të kursyer energji.
- Mos e shpëlani me ujë të rrjedhshëm. Vetëm kruani mbeturinat e ushqimeve para se ta mbushni lavastoviljen.
- Zgjidhni një detergjent që nuk është i dëmshëm për mjedisin. Lexoni deklaratën mjedisore në paketim!
- Nëse enët janë vetëm pak të pista, mund të zgjidhni një program me temperaturë të ulët.
- Arrihen rezultate më të mira tharjeje nëse përdorni opsionin Hapje automatike i cili hap automatikisht derën e lavastoviljes në fund të programit. (Nëse lavastovilja është e inkuar, mobilet pranë duhet të jenë rezistente ndaj çfarëdo kondensimi.)

Enët delikate

Disa enë gatimi nuk mund të lahen në lavastovilje. Kjo mund të jetë për arsye të ndryshme. Disa materiale nuk mund t'i rezistojnë nxehtësisë të lartë, të tjera mund të dëmtohen nga detergjenti i lavastoviljes.


Bëni kujdes, për shembull, me gjërat e punuara me dorë, dekorimet delikate, enët prej qelqi/kristali, argjendi, bakri, kallaji, alumini, druri dhe plastike. Kërkoni nëse kanë shënimin "Për lavastovilje".

Shportat e lavastoviljes

Lavastovilja është e pajisur me një tabaka të sipërme për thikat dhe pirunët, një shportë të sipërme dhe një shportë të poshtme.

Tabakaja e sipërme e thikave dhe pirunëve



Tabakaja e sipërme e thikave dhe pirunëve ka hapësirë për thikat dhe pirunët, garazhdet dhe gjëra të ngjashme.



Shportat e sipërme


Vendosini gotat, tasat, pjatat e mëdha dhe të vogla në shportën e sipërme. Të gjitha sipërfaqet e pista duhet të drejtohen për brenda dhe jashtë! Gotat e verës vendosen

në mbajtësen e gotave të verës dhe thikat vendosen në mbajtësen e thikave djathtas (nëse ka).



Ngritja dhe ulja e shportës të sipërme


- 1 Tërhiqeni shportën e sipërme.
- 2 Kapini anët e shportës të sipërme me të dyja duart dhe ngrijeni lart.
- 3 Ngrijeni vazhdimisht shportën me të dyja duart për të ndryshuar pozicionin. (Shportat e sipërme mund të vendoset në tre pozicione.) Kur shportat e sipërme të jenë në pozicionin më të lartë, ngritja më tej do ta çojë në pozicionin më të ulët. Vini re se të dyja anët e shportës duhet të jenë të vendosura gjithmonë në të njëjtën lartësi.



Majat e palosshme


Majat e palosshme mund të palosen për lart ose poshtë për ta bërë më të lehtë vendosjen e tenxhereve, tasave dhe

gotave. Lëshojini majat e palosshme duke shtypur kapësen për brenda para se të rregulloni pozicionin e tyre.



Shporta e poshtme

Vendosini pjatat e mëdha e të vogla, enët e tavolinës dhe tenxheret në shportën e poshtme.



Majat e palosshme

Palosini majat e palosshme (mbajtëset e pjatave) kur lani tenxhere. Lirojini majat e palosshme duke shtypur kapësen për brenda para se të rregulloni pozicionin e tyre.


Pika që duhen pasur parasysh

- Të gjitha sipërfaqet e palara duhet të drejtohen për brenda dhe për poshtë!
- Enët nuk duhet të vendosen brenda ose sipër njëra tjetrës.
- Anojini enët me gropë si filxhanët në mënyrë që uji i shpëlarjes të derdhet. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për gjërat plastike.
- Sigurohuni që gjërat e vogla të mos bien në shportën e larjes së enëve; vendosini në shportën e sipërme të thikave dhe pirunëve.

SHËNIM!

Kontrolloni që krahët e spërkatjes të rrotullohen lirshëm.

Shtoni detergjent



- Vendi i detergjentit të paralarjes
- Vendi i detergjentit të larjes kryesore

Detergjenti hidhet sipas fortësisë të ujit.

Ndiqui udhëzimet në paketimin e detergjentit. Kjo lavastovilje është e pajisur me zbutës uji, prandaj përdorni doza detergjenti dhe solucioni shkëlqyes të përshtatshme për ujë të butë.

Përdorimi i detergjentit të tepërt mund të çojë në larje enësh më pak të efektshme dhe gjithashtu ndikon për keq në mjedis.

Mbajtësja e detergjentit duhet të jetë e thatë kur shtoni detergjentin. Ka një vend për paralarjen dhe një për larjen kryesore. Nëse përdoret detergjenti pluhur ose lëng, shtoni një sasi të vogël detergjenti në vendin e paralarjes. Kontaktoni prodhuesin e detergjentit nëse keni pyetje rreth detergjentit.

SHËNIM!

Përdorni vetëm detergjent për larje enësh! Nuk duhet të përdoret larës lëng pasi shkuma që formohet nuk lejon lavastoviljen të punojë mirë.

Tableta lavastoviljesh

Ndajeni tabletën përgjysmë nëse është e vështirë ta mbyllni kapakun e detergjentit. Ekziston rreziku që detergjenti të mos dalë mirë nëse kapaku është i shtrënguar dhe nuk hapet mirë.

SHËNIM!

Tabletat e lavastoviljeve rekomandohen për programe të shkurtra (më pak se 75 minuta). Në vend të tyre, përdorni detergjent pluhur ose lëng për lavastovilje.

Detergjenti 3-në-1/gjithçka-në-një

Kapitulli Rregullimet tregon si të aktivizoni TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një). Vini re se kripa duhet të vendoset në vendin e kripës. Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatet e larjes ose tharjes të enëve, çaktivizoni rregullimin TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një) dhe mbusheni me kripë,

detergjent dhe solucion shkëlqyes. Shiko kapitullin Para se të lani për herë të parë.

Lexoni me kujdes udhëzimet për këto produkte. Nëse ka diçka të paqartë, kontaktoni me prodhuesin e detergjentit.

Butoni kryesor i ndezjes

Shtypni dhe mbani shtypur çelësin e energjisë derisa të ndizet ekrani. Gjithashtu kontrolloni që rubineti i ujit është e hapur.

PROGRAMS - Zgjidhni programin

Zgjidhni një program për t'iu përshtatur llojit të enëve dhe sa të palara janë.

Shtypni programin e dëshiruar derisa të aktivizohet simboli i programit.

auto
45-65° **Larje automatike**

Lavastovilja mund të llogaritet sa të pista janë enët dhe të rregullojë konsumin dhe temperaturën e ujit sipas kësaj. Kur sapo është montuar, programi duhet të vihet në punë pesë herë para se të përshtatet plotësisht dhe të japë rezultatet më të mira.

auto
45-65° **Larje automatike**¹⁾ +  **SpeedWash** + 

Hapje automatike
Program i efektshëm për përdorimin e përditshëm për enët e pista pak të thara. (Ky program nuk është bërë për ushqimet e djegura, si për shembull enët e furrës.)



70° **Larje intensive**

Program për enë shumë të pista si tiganë, tenxhere dhe enë furre. Nëse këto enë nuk e mbushin lavastoviljen plot, atëherë mund të shtoni pjata dhe gjëra të ngjashme.

eco
55° **Larje ekonomike**

Ky program është bërë për të larë enë të ndotura normalisht dhe është programi më i efektshëm për sa i përket konsumit të energjisë dhe ujit të kombinuar së bashku.



35° **Larje e shpejtë**

Ky program përdoret për enët prej qelqi dhe porcelani që janë pak të pista, si filxhanët e kafes.

Në kombinim me SpeedWash, arrihet një program më i shkurtër (15 minuta).



*° **Shplarje**

Përdoret për të shpëlarë enët ndërkohë që prisni që lavastovilja të mbushet plot.

EXTRA - Zgjedhja e opsioneve

Për të zgjedhur një opsion, shtypni një nga butonat e opsioneve derisa të aktivizohet opsioni. Opsionet e disponueshme ndryshojnë midis programeve dhe disa opsione nuk mund të kombinohen (opsionet e disponueshme ndriçojnë pak).



SpeedWash

Ky opsion shkurtin kohën e programit, por përdor më pak energji dhe ujë.



Hapje automatike

Dera e lavastoviljes hapet automatikisht në fund të programit e cila përmirëson rezultatet e tharjes. (nëse lavastovilja është montuar inkaso, mobiliet rotull duhet të jenë rezistente ndaj kondensimeve.)

SHËNIM!

Dera e lavastoviljes nuk duhet bllokuar kur është vendosur që të hapet vetë. Kjo mund të pengojë funksionin e kyçjes të derës.



Higjenë ekstra

Ky opsion është bërë për situata ku kërkesa për higjienën është shumë e lartë, si për shembull kur lani shishe biberonësh dhe dërrasa për grirje. Temperatura rritet qoftë në larjen kryesore ashtu edhe në shpëlarjen finale.



Fillim i vonuar

Kur zgjidhni Fillim i vonuar lavastovilja do të fillojë të punojë 1-24 orë pasi ta mbyllni derën.

- 1 Shtypni butonin njëherë për të aktivizuar Fillim i vonuar. Shtypni butonin disa herë – ose mbajeni shtypur – për të vendosur numrin e dëshiruar të orëve.
- 2 Mbylleni derën dhe lavastovilja numëron mbrapsht nga 1 orë me radhë dhe fillon pas shtyrjes të zgjedhur.

Nëse doni ta anuloni opsionin Fillim i vonuar, hapeni derën dhe shtypni e mbani shtypur butonin kryesor të ndezjes derisa të fiket ekrani.

Vëreni lavastoviljen në punë

Mbylleni derën për ta vënë lavastoviljen në punë. Nëse butoni kryesor i ndezjes është i ndezur, lavastovilja do të fillojë automatikisht kur të mbyllet dera.

¹⁾ Ky kombinim (Larje automatike + SpeedWash + Hapje automatike) njihet gjithashtu si QuickIntensive (90 minuta).

TIME - Koha e mbetur

Pasi të keni zgjedhur një program dhe opsionet, shfaqet koha që u desh kur u përdor programi për herë të fundit.

Ndalimi ose ndryshimi i një programi

Nëse doni të ndryshoni një program pasi ta keni vënë lavastoviljen në punë, hapeni derën dhe shtypni e mbani shtypur butonin kryesor të ndezjes derisa të fiket ekrani. Shtoni më shumë detergjent nëse është hapur shpërndarësi i detergjentit. Pastaj shtypni butonin kryesor të ndezjes, zgjidhni një program të ri dhe mbylleni derën.

Doni të shtoni enë të tjera?

Hapeni derën. Lavastovilja ndalon vetë. Shtoni enët dhe mbylleni derën. Pas pak, lavastovilja vazhdon programin.

Nëse lavastovilja fiket për shkak të një ndërprerjeje energjie

Nëse programi i larjes nuk kishte mbaruar, programi i ndërprerë vazhdon kur të rikthehet energjia.

SHËNIMI!

Gjatë tharjes, programi ndërpritet nëse shkëputet energjia ose hapet dera për më shumë se 2 minuta.

Si të arrini rezultatet më të mira të tharjes

- Mbusheni lavastoviljen plot.
- Anojini enët me gropë si filxhanët në mënyrë që uji i shpërlarjes të derdhet. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për gjërat plastike.
- Mbusheni me solucion shkëlqyes ose shtoni nivelin e dozës të solucionit të shkëlqyes.
- Aktivizoni opsionin Hapje automatike.
- Lëri enët të ftohen para se t'i nxirrni nga lavastovilja.

Pasi ka mbaruar programi

Fundi i programit tregohet nga një sinjal i shkurtër. Shikoni kapitullin Rregullimet tregon si ta ndryshoni këtë funksion.


Lavastovilja fiket vetë pasi mbaron programi. Mbylleni rubinetin e ujit pas çdo përdorimi.

Zbrazeni lavastoviljen

Porcelani i nxehtë është më delikat. Lëri enët të ftohen në lavastovilje para se t'i nxirrni.

Zbrazni më parë shportën e poshtme në mënyrë që pikat e ujit nga shporta e sipërme të mos bien në enët në shportën e poshtme.

Programet speciale



Shtypni dhe mbani shtypur butonat përkatës të opsioneve për të aktivizuar një program special. Programi fillon kur mbyllet dera.

Program vetëpastrimi (CLn)

Program vetë-pastrues për pastrimin higjienik të kazanit, krahëve të spërkatjes dhe tubave të spërkatjes në lavastovilje.

Ky program mund të vihet në punë (pa enë brenda) duke përdorur detergjent normal lavastoviljesh ose acid citrik. Ka gjithashtu në treg solucione të veçanta për lavastovilje. Për heqjen e depozitimeve të kalkarit, shikoni Kazani i lavastoviljes në kapitullin Kujdesi dhe pastrimi.

Grafiku i programeve

PROGRAMS - Programi	Mbajtësja e detergjentit 1 / 2 (ml)	EXTRA - Opsionet	Paralarje	Larja kryesore	Numri i shpëlarjeve	Shpëlarja finale	Vlerat e konsumit ¹⁾		
							Koha e larjes (afërsisht orë: min)	Energjia (afërsisht kWh)	Kons. i ujit (L)
Larje automatike	--- / 25	Hapje automatike	1-3	50-65 °C	2-3	65 °C	2:10-2:50	0,9-1,5	11-20
Larje intensive	10 / 25		2	70 °C	2	70 °C	2:55	1,7	17
Larje ekonomike ²⁾	--- / 25	Hapje automatike	1	55 °C	2	49 °C	3:00	0,86	9,5
Larje e shpejtë	--- / 10			35 °C	1	25 °C	0:20	0,2	10
Shpëlarje	--- / ---				1	--- °C	0:07	0,01	3

1) Vlerat e konsumit varen nga temperatura e ujit që hyn, temperatura e dhomës, sasia e mbushjes, funksionet shitesë të zgjedhura dhe të tjera.

2) Ky program për larjen e enëve është cikël standard i përcaktuar për të përpiluar informacionet e klasifikimit të energjisë. Është bërë për larjen e enëve të ndotura normalisht dhe është programi më i efektshëm për sa i përket konsumit të energjisë dhe ujit të kombinuar së bashku.

Hapni menunë e rregullimeve:

- 
1. Në fillim hapni derën. Fikeni pajisjen. Shtypni dhe mbani shtypur butonin kryesor të ndezjes derisa të ndizet ekrani.

2. Brenda 10 sekondash:
- shtypni butonin e programit Larje automatike dhe butonin e opsionit SpeedWash.

3. Ekrani tregon menunë e rregullimeve (rregullimi aktual dhe vlera e vendosur aktualisht).
(Dilni nga menuja duke ecur nëpër menu ose duke shtypur butonin kryesor të ndezjes.)


Lëvizja në menunë e rregullimeve:



Rregullimet	Opsionet	
3. TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një)	3:00 (Fikur) 3:01 (Ndezur)	Mund ta aktivizoni këtë rregullim 3-në-1/ detergjent gjithçka në një. Programet e lavastoviljes përshtaten automatikisht për të dhënë rezultatet më të mira të mundshme të larjes dhe tharjes në çdo rast. Nëse aktivizohet ky rregullim, atëherë nuk ka nevojë të shtoni solucion shkëlqyes pasi ky opsion e çaktivizon hedhjen e solucionit shkëlqyes. Gjithashtu pakëson sasinë e kripës që shtohet në zbutësin e ujit. Vini re se kripa duhet të futet në vendin e kripës. SHËNIM! Për të arritur rezultate të mira në larjen e enëve, është shumë e rëndësishme të kontrollohet cili lloj detergjenti ose produkti gjithçka-në-një i përshtatet më mirë nevojave tuaja! Lexoni me kujdes paketimin e detergjentit për informacione mbi përdorimin e duhur. Gjithmonë ndiqni udhëzimet për përdorimin ose informacionet në paketimin e detergjentit!
4. Volumi i sinjalit	4:00 - 4:03	Lavastovilja lëshon një sinjal për të treguar kur ka mbaruar programi ose kur ka ndodhur një defekt.

Filtri i trashë


Filtri i trashë kap copat e mëdha të ushqimeve të cilat nuk lejohen të kalojnë në pompën e shkarkimit. Zbrazeni filtrin e trashë sipas nevojës.



- 1 Kapeni filtrin e trashë nga doreza.
- 2 Zbrazeni filtrin e trashë. Mos harroni ta vini përsëri në vend.

Filtër i imët

Mbeturinat që grumbullohen te filtri i imët shpëlahen automatikisht gjatë çdo larjeje. Pastrojeni filtrin e imët kur është e nevojshme.



- 1 Rrotullojeni dorezën në drejtim të kundërt të akrepave të orës.
- 2 Ngrijeni filtrin drejt duke përdorur dorezën. Shkëputeni filtrin e trashë për të pastruar filtrin e imët.
- 3 Vendoseni përsëri në radhë të kundërt. Kontrolloni që anët e gominës të izoloohen mirë kur vini në vend filtrin e imët.
- 4 Futeni filtrin në vend duke rrotulluar dorezën në drejtim të akrepave të orës në pozicionin e ndalimit. Doreza duhet të jetë në drejtim lart drejt në lavastovilje.


SHËNIM!

Nuk duhet të përdoret lavastovilja pa filtrat në vend!

Mund të ndikohen rezultatet e larjes nëse filtri i trashë nuk montohet mirë.

Krahët e spërkatjes


Vrimat dhe kushinetat mund të bllokohen ndonjëherë. Hiqni çdo mbeturinë duke përdorur një kunjë ose diçka të ngjashme. Krahët spërkatëse kanë gjithashtu vrima poshtë tyre.



Për ta bërë pastrimin më të lehtë, mund t'i hiqni krahët e spërkatjes. Mos harroni t'i vini mirë në vend pas kësaj.


Krahu i poshtëm i spërkatjes

- Ngrijeni drejt lart krahun e poshtëm të spërkatjes për ta liruar.



Krahu i sipërm i spërkatjes

- 1 Tërhiqeni shportën e sipërme.
- 2 Zhvidhosni kushinetat e krahut të spërkatjes në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta hequr krahun e spërkatjes nga shporta e sipërme.



Dera dhe gomina e derës

Pastroni rregullisht anët e derës dhe gominën e derës. Përdorni një leckë pak të njomë (me pak detergjent nëse është e nevojshme).

Kazani i lavastoviljes

Kazani i lavastoviljes është prej inoksi dhe qëndron i pastër gjatë përdorimit normal.

Depozitimet e kripërave

Nëse keni ujë të fortë, mund të grumbullohen depozitime kripërash në lavastovilje. Nëse ndodh kjo, bëni një program vetë-pastrimi me dy lugë acidi citrik në vendin e detergjentit (pa enë në pajisje). Shikoni Program vetëpastrimi në kapitullin Përdorimi i lavastoviljes.

Paneli përpara

Mbajini butonat të pastër dhe pa yndyrma. Fshijini me leckë të thatë ose pak të njomë. Asnjëherë mos përdorni solucion pastrimi - ato mund ta gërvishin sipërfaqen. Përdorni butonin kryesor të ndezjes për ta fikur lavastoviljen para se të pastroni butonat për të shmangur aktivizimin e butonave padashur.


Zhblokim i pompës së zbrazjes

Nëse lavastovilja ka akoma ujë pasi ka mbaruar programi, ka diçka që mund të ketë bllokuar pompën e zbrazjes. Këto gjëra hiqen me lehtësi.

- 1 Fikeni pajisjen duke përdorur çelësin e energjisë dhe hiqeni nga priza në mur.
- 2 Hiqni filtrin e trashë dhe filtrin e imët.
- 3 Nxirreni ujin nga kazani i lavastoviljes.
- 4 Për të kontrolluar pompën e shkarkimit, hiqeni stopin me ngjyrë në të djathtë të pilotës të poshtme.
- 5 Rrotulloni me dorë rrotën e pompës që ndodhet mbrapa stopit të pompës së zbrazjes. Hiqni me kujdes çdo gjë.
- 6 Vendoseni përsëri stopin e pompës të shkarkimit bashkë me filtrin e imët dhe të trashë.
- 7 Futni përsëri pajisjen në prizë.

Nëse lavastovilja nuk fillon të punojë ose dëgjohet një zhurmë, atëherë është aktivizuar mbrojtja e tejmbushjes.

- Mbylleni ujin.
- Hiqni spinën nga priza në mur.
- Telefononi servisin.




SHËNIM!

Mos harroni ta vini në vend stopin e pompës të shkarkimit.

Zhblokim i filtrit të tubit të hyrjes së ujit

Nëse uji përmban grimca të vogla, filtri i jashtëm në tubin e hyrjes së ujit mund të bllokohet e cila rezulton në Problem në mbushjen me ujë.

- 1 Fikeni pajisjen duke përdorur çelësin e energjisë dhe hiqeni nga priza në mur.
- 2 Mbylleni ujin e çezmës.
- 3 Zhvidhoseni tubin e hyrjes së ujit.
- 4 Hiqeni me kujdes filtrin e jashtëm nga tubi i hyrjes së ujit dhe pastrojeni.
- 5 Vendoseni përsëri filtrin dhe kontrolloni që guarnicioni të jetë pozicionuar mirë.
- 6 Vidhoseni mirë në vend tubin e hyrjes së ujit.
- 7 Futni pajisjen në prizën në mur dhe hapeni rubinetin e ujit. Lëreni presionin të bjerë pak dhe kontrolloni që lidhja është hermetike.



Zgjidhja e problemeve

Lloji i defektit në ekran		Veprimi
F10	Mbingarkesë	Pastroni pompën e shkarkimit. Shikoni pjesën Kujdesi dhe pastrimi. Nëse problemi vazhdon, telefononi servisën.
F11	Problem në daljen e ujit	Shikoni "Mbetet ujë në lavastovilje" në tabelën "Problemi" më poshtë. Nëse problemi vazhdon, telefononi servisën.
F12	Problem në mbushjen me ujë	Kontrolloni që uji i çezmës është i hapur. Nëse problemi vazhdon, thërrisni departamentin e shërbimit.
F40	Kullim uji në hyrjen e ujit	Mbylleni rubinetin e ujit dhe telefononi servisën.
F52	Gabim në nivelin e ujit	Telefononi servisën.
F54	Mbingarkesë	Mbylleni rubinetin e ujit dhe telefononi servisën.
F56	Gabim në qarkullim	Telefononi servisën.


Shtypni çfarëdo butoni për të hequr mesazhin e gabimit.

Problemi	Shkaqet e mundshme	Veprimi
Butonat nuk reagojnë kur shtypen.	I keni shtypur butonat shumë shpejt pasi keni hapur derën.	Prisni një moment dhe provoni përsëri.
	Butonat janë të pistë.	Pastrojeni me një leckë të thatë ose pak të njomë.
	Dera është e mbyllur.	Hapeni derën. Butonat reagojnë vetëm kur dera është e hapur.
Dera nuk mbyllet.	Shportat nuk janë në pozicionet e duhura.	Kontrolloni që shportat të jenë pozicionuar mirë horizontalisht.
		Kontrolloni që enët të mos pengojnë shportat të shkojnë në vend.
	Kyçi i derës nuk klikon në vend dhe nuk kyçet.	Kontrolloni kyçin e derës. Nëse nuk klikon në vend dhe nuk kyçet, hapeni derën. Shtypni dhe mbani shtypur butonin për opsionin Hapje automatike 15 sekonda. Pastaj prisni 30 sekonda. Mbylleni derën. Kontrolloni që kyçi i derës të klikojë në vend dhe të kyçet.

Problemi	Shkaqet e mundshme	Veprimi
Lavastovilja nuk fillon të punojë.	Dera nuk është mbyllur mirë.	Kontrolloni.
	Keni hapur lavastoviljen për të shtuar më shumë enë ndërsa është në punë një program.	Mbylleni derën dhe prisni. Pas pak, lavastovilja vazhdon programin.
	Kyçi i derës nuk ka klikuar në vend dhe nuk është kyçur.	Kontrolloni kyçin e derës. Nëse nuk ka klikuar në vend dhe nuk është kyçur, hapeni derën. Shtypni dhe mbani shtypur butonin për opsionin Hapje automatike 15 sekonda. Pastaj prisni 30 sekonda. Mbylleni derën. Kontrolloni që kyçi i derës të klikojë në vend dhe të kyçet.
	Ka rënë një siguresë/automat.	Kontrolloni.
	Nuk është futur spina në prizë.	Kontrolloni.
	Rubineti i ujit është i mbyllur.	Kontrolloni.
	Tejmbushje/rrijdhje.	Kontrolloni.
	Dëgjohet një zhurmë gumëzhitëse (pompa e shkarkimit) nga lavastovilja dhe nuk ndalon kur butoni kryesor i ndezjes është i fikur.	Mbylleni rubinetin e ujit. Hiqeni spinën dhe telefononi servisin.
Enët nuk janë të pastra.	Kontrolloni që të mos jetë zgjedhur opsioni Fillim i vonuar.	Shtypni dhe mbani shtypur butonin kryesor të ndezjes derisa të fiket ekрани nëse doni të ndaloni opsionin Fillim i vonuar. Vëreni përsëri lavastoviljen në punë.
	Krahët spërkatëse nuk rrotullohen.	Hiqini krahët dhe pastrojini. Kontrolloni që enët të mos bllokojnë krahët e spërkatjes.
	Detergjent i vjetër. Detergjenti është produkt që prishet.	Shmangini paketimet e mëdha.
	Dozë e gabuar detergjenti.	Doza vendoset sipas fortësisë të ujit. Detergjenti i tepërt ose i pamjaftueshëm sjell rezultate të dobëta në larjen e enëve.
	Program i papërshtatshëm për larjen e enëve.	Zgjidhni një program më të gjatë.
	Enët nuk janë vendosur mirë.	Mos i mbuloni porcelanet me tasa të mëdhenj ose enë të ngjashme. Mos i vendosni gotat e gjata në cepat e koshave.
	Gotat dhe filxhanët janë rrëzuar gjatë programit.	Vendosini enët që të qëndrojnë pa lëvizur.
	Filtri nuk është montuar mirë.	Vidhoseni filtrin fort në vend. Shikoni pjesën Kujdesi dhe pastrimi.

Problemi	Shkaqet e mundshme	Veprimi
Njolla në inoks ose argjend.	Disa ushqime si për shembull mustarda, majonezi, limoni, uthulla, kripa dhe salcat mund të njosin inoksin nëse lihen për kohë të gjatë.	Shpëllajini menjëherë këto lloje produktesh nëse nuk e vini lavastoviljen në punë menjëherë. Pse të mos përdorni programin Shplarje?
	Të gjitha enët prej inoksi mund të shkaktojnë njolla në argjend nëse bien në kontakt gjatë larjes. Alumini mund të shkaktojë gjithashtu njolla në enë.	Për të shmangur shenjat dhe gërvishtjet, ndajini enët që janë prej materialesh të ndryshme, si argjendi, inoksi dhe alumini.
Njolla ose cipa në enë.	Zbutësi i ujit rrjedh kripë.	Kontrolloni që kapaku i vendit të kripës të jetë shtrënguar mirë. Përndryshe telefononi servisin.
	Rregullim i gabuar i fortësisë të ujit.	Shikoni pjesën Rregullimet.
	Rregullim i gabuar i dozës të solucionit shkëlqyes.	Shikoni pjesën Rregullimet.
	Vendi i kripës bosh	Mbusheni me kripë. Shikoni pjesën Para se të lani për herë të parë.
	Është përdorur detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një dhe është aktivizuar rregullimi TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një).	Çaktivizoni rregullimin TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një) dhe mbusheni me kripë dhe solucion shkëlqyes.
	Temperatura shumë e lartë dhe/ose detergjenti i tepërt mund të shkaktojë gërvishje në kristal. Fatqësisht, kjo nuk mund të riparohet, vetëm të parandalohet.	Lajini enët prej kristali në temperatura të ulëta dhe me sasi të vogël detergjenti. Kontaktoni prodhuesin e detergjentit.
Enët kanë një shtresë ngjitëse të bardhë/cipë blu.	Rregullimi i dozës të solucionit shkëlqyes shumë i lartë.	Ulni sasinë. Shikoni pjesën Para se të lani për herë të parë dhe Rregullimet. Nëse keni ujë shumë të butë, mund të doni ta holloni solucionin shkëlqyes 50:50 me ujë.
Njolla të lëna pas larjes.	Buzëkuqi dhe çaji mund të jenë të vështirë të lahen.	Përdorni detergjent me agjent zbardhues.
Mbetje detergjenti në mbajtësen e detergjentit pas larjes së enëve.	Mbajtësja e detergjentit ishte e njomë kur hodhët detergjentin.	Mbajtësja e detergjentit duhet të jetë e thatë kur shtoni detergjentin.
Zhurme kërcitjeje kur lahen enët.	Enët nuk janë vendosur mirë ose krahët e spërkatjes nuk rrotullohen.	Kontrolloni që enët të jenë vendosur mirë. Rrotulloni krahët e spërkatjes për t'u siguruar që rrotullohen lirshëm.
Mbetet ujë në lavastovilje.	Janë bllokuar filtrat.	Pastrojeni filtrin e trashë dhe të imët.
	Mbeturina në pompën e shkarkimit.	Pastroni pompën e shkarkimit. Shikoni pjesën Kujdesi dhe pastrimi.
	Përdredhje në tubin e shkarkimit.	Kontrolloni që tubi të mos ketë përdredhje dhe thyerje.
	Tubi i shkarkimit është bllokuar.	Shkëputeni tubin e shkarkimit ku lidhet me sifonin. Kontrolloni që të mos ketë mbeturina dhe që lidhja të ketë një diametër të brendshëm prej të paktën 14 mm.

Problemi	Shkaqet e mundshme	Veprimi
Erë e keqe në lavastovilje.	Papastërti rrotull gominave dhe në cepa.	Pastrojeni me furçë dhe solucion me shkumëzim të ulët.
	Janë zgjedhur programe me temperaturë të ulët për një periudhë të gjatë.	Vini në punë një program me temperaturë të lartë rreth njëherë në muaj.
Enët nuk janë të thara mjaft.	Nuk është aktivizuar opsioni Hapje automatike.	Aktivizoni opsionin Hapje automatike.
	Lavastovilja nuk është mbushur plot.	Mbusheni lavastoviljen plot.
	Ka nevojë të mbushet me solucion shkëlqyes ose doza është shumë e ulët.	Mbusheni me solucion shkëlqyes ose rriteni dozën e solucionit shkëlqyes. Shikoni pjesët Para se të lani për herë të parë dhe Rregullimet.
	Është përdorur detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një dhe është aktivizuar rregullimi TAB (detergjent 3-në-1/ gjithçka-në-një).	Çaktivizoni rregullimin TAB (detergjent 3-në-1/gjithçka-në-një) dhe mbusheni me kripë dhe solucion shkëlqyes.




Udhëzimet e sigurisë

- Lidhjet me energjinë, ujin dhe shkarkimin duhet të bëhen nga një profesionist i kualifikuar.
- Gjithmonë ndiqni rregullat në fuqi për ujin, shkarkimin dhe energjinë elektrike.
- Bëni kujdes gjatë instalimit! Vishni doreza mbrojtëse! Duhet të ketë gjithmonë dy njerëz!
- Vendosni një tabaka që mban ujin poshtë lavastoviljes për të mos lejuar dëmtimet nga derdhjet e ujit.
- Para se ta vidhosni lavastoviljen në vend, provojeni lavastoviljen duke vënë në punë programin Shplarje. Kontrolloni që lavastovilja mbushet dhe shkarkon ujin. Kontrolloni gjithashtu që asnjë prej lidhjeve të mos rrjedhë.

Mbrojtja e derës nga transporti

Mos harroni ta hiqni mbrojtësen e derës nga transporti kur shpaketoni lavastoviljen.



⚠ PARALAJMËRIM!


Mbylleni hyrjen e ujit kur montoni lavastoviljen!

⚠ PARALAJMËRIM!

Spina duhet të jetë e shkëputur ose të energjia në prizë të jetë e fikur kur bëhen punët!

Vendosja e lavastoviljes

Lavastovilja është bërë për montim poshtë një banaku. Përmasat e vendit të futur janë treguar në figurë. Sigurohuni që anët e këtyre vrimave të jenë lëmuara për të mos lejuar dëmtimet e tubave të shkarkimit e hyrjes dhe kablilit të energjisë.




Ngjitni filmin mbrojtës

Vendosni një film mbrojtës (të futur në qesen e dokumenteve) në pjesën e poshtme të banakut. Fleta mbrojtëse shërben për të mbrojtur banakun nga lagështia.


SHËNIM!

Sipërfaqja në të cilin ngjitet filmi mbrojtës duhet të jetë e pastër dhe e thatë.



Rregulloni lartësinë dhe futni lavastoviljen në vend.


- 1 Filloni duke matur lartësinë nga dyshemeja në anën e poshtme të banakut.
- 2 Matni lartësinë nga dyshemeja në anën e sipërme të lavastoviljes.
- 3 Rregulloni këmbët e lavastoviljes duke i rrotulluar në drejtim të akrepave të orës për ta ulur pajisjen.



- 4 Kontrolloni që të ketë një hapësirë bosh prej të paktën 3 mm midis anës të poshtme të banakut dhe pjesës të sipërme të lavastoviljes.

- 5 Futni lavastoviljen në vend.

- Tërhiqni tubat e shkarkimit dhe furnizimit kur pajisja të jetë futur në vend.
- Kontrolloni që tubat të mos kenë përdredhje ose thyerje të mprehta dhe kontrolloni që të mos ketë asgjë që mund të dëmtojë tubat.







- Kontrolloni që pajisja të montohet në një lartësi që dera të hapet lirshëm, ndryshe funksioni i kyçjes së derës mund të pengohet.

- 6 Bëni çfarëdo rregullimi të fundit në këmbët përpara (lavastovilja nuk duhet të anohet më shumë se 5 mm).

Lidhja e shkarkimit

Kjo lavastovilje është e përshtatshme për montim në një vend të ngritur (për të arritur një lartësi punimi ergonomike). Kjo do të thotë që lavastovilja mund të vendoset në mënyrë të tillë që tubi i shkarkimit të kalojë në një nivel më të ulët se fundi i lavastoviljes, si për shembull duke e kaluar direkt në një shkarkim në dysheme. Lavastovilja është e pajisur me një mjet anti-sifon për të mos lejuar që pajisja të zbrazet nga uji gjatë ciklit të larjes.





Tubi i shkarkimit mund të lidhet gjithashtu me një grykë lidhjeje në lavaman. Gryka e lidhjes duhet të ketë një diametër të brendshëm prej të paktën 14 mm.

Tubi i shkarkimit mund të zgjatet deri në një maksimum prej 3 m (gjatësia totale e tubit të shkarkimit nuk duhet t'i kalojë 4,5 m). Çdo bashkim dhe tubat e lidhjes duhet të kenë një diametër të brendshëm prej 14 mm. Sidoqoftë, tubi i shkarkimit është mirë të ndërrohet me një tub të ri pa bashkime.

Asnjë pjesë e tubit të shkarkimit nuk mund të jetë më shumë se 950 mm sipër fundit të lavastoviljes.

Sigurohuni që tubi i shkarkimit të mos ketë përdredhje.

Lidhja me furnizimin e ujit

Përdorni vetëm tubin e hyrjes së ujit që është dhënë bashkë me lavastoviljen. Mos i ri-përdorni tubat e vjetër ose tuba të tjerë rezervë.

Tubi i hyrjes së ujit duhet të lidhet me ujin e çezmës (rubinet). Rubineti duhet të arrihet me lehtësi në mënyrë që uji të mbyllet në rast se duhet të lëvizet lavastovilja.

Pasi të ketë mbaruar montimi, hapeni ujin e çezmës dhe lëroni presionin të bjerë për pak. Kontrolloni që të gjitha lidhjet të jenë hermetike.

Lidhja me ujin e ftohtë

Lidhjeni lavastoviljen me ujin e ftohtë nëse ndërtesa ngrohet me naftë, korrent ose gaz.

Lidhja me ujin e ngrohtë

Lidhjeni lavastoviljen me ujin e ngrohtë (maks. 70 °C) nëse ndërtesa ngrohet duke përdorur mjete ekonomike për energjinë si ngrohje qarku, energji diellore ose energji gjeotermale. Zgjedhja e një lidhjeje me ujë të ngrohtë pakëson kohën e larjes së enëve dhe pakëson konsumin e energjisë të lavastoviljes.

SHËNIM!

Mos e tejkaloni temperaturën maksimale të lejuar për ujin. Disa materiale të përdorura në enë gatimi nuk i rezistojnë nxehtësisë së madhe. Shikoni Enët delikate në kapitullin Mbushja e lavastoviljes.

Lidhja elektrike

Informacionet rreth lidhjes elektrike mund të gjenden në etiketën e numrit të serisë. Këto specifikime duhet të përshtaten me rrjetin e energjisë elektrike.


Lavastovilja duhet të lidhet me një prizë me tokëzim.

Priza elektrike në mur duhet të vendoset jashtë vendit të instalimit në mënyrë që të arrihet me lehtësi pas montimit të lavastoviljes. Mos përdorni kabell zgjatues!

SHËNIM!


Riparimet dhe punët e mirëmbajtjes që lidhen me sigurinë ose performancën duhet të bëhen nga një profesionist i kualifikuar.

Vidhosja e lavastoviljes në vend




Pasi ta shtrëngoni pajisjen, kontrolloni që këmbët e para përsëri të prekin në dyshe me.

Instalimi dhe izolimi i zhurmës




Lexoni kapitullin Zgjidhja e problemeve para se të kontaktoni departamentin e shërbimit. Nëse keni hasur një problem që nuk mund ta zgjidhni, ju lutem kontaktoni shitësin më të afërt, shikoni www.gorenje.com.

Kur kontaktoni, jepni detajet në etiketën e numrit të serisë. Përfshini numrin e artikullit (1) dhe numrin e serisë (2).



Kërkoni informacionet e institutit të testimit me email dishwashers@appliance-development.com.

Kërkesa duhet të përfshijë detajet në etiketën e numrit të serisë. Përfshini numrin e artikullit (1) dhe numrin e serisë (2).



[illegible]

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on the right side, suggesting it's resting on a surface. There is no handwriting or other markings on the paper.

Informacione mbi klasifikimin e energjisë

Fletë informacionesh, në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) Nr. 1059/2010

Gorenje

Caktimi i modelit:	GV60ORA
Numri i rregullimeve standarde të vendit:	16 ¹⁾
Klasi i efikasitetit të energjisë:	A+++
Konsumi vjetor i energjisë(AE _C):	245 kWh në vit ²⁾
Konsumi i energjisë të ciklit të larjes standarde(E _p):	0,86 kWh
Konsumi i energjisë	
Gjendje e fikur (P _o):	0,49 W
Gjendje e lënë ndezur (P _i):	0,49 W
Konsumi vjetor i ujit (AW _C):	2660 litra në vit ³⁾
Klasi i efikasitetit të tharjes:	A ⁴⁾
Programi standard:	Larje ekonomike ⁵⁾ , opsioni Hapje automatike
Koha e programit për ciklin e larjes standarde:	180 minuta
Kohëzgjatja e gjendjes të lënë ndezur (T _i):	Pa fund
Emetimet e zhurmës:	45 dB(A) re 1 pW
Ndërtimi:	Produkt inkaso

1) Sipas standardit, EN 50242.

2) Bazuar në 280 cikle larjeje standarde me lidhje uji të ftohtë dhe konsum sipas metodës të kursimit të energjisë. Konsumi real i energjisë varet nga mënyra si përdoret pajisja.

3) Bazuar në 280 cikle larjeje standarde. Konsumi vjetor i ujit varet nga mënyra si përdoret pajisja.

4) Në shkallë nga G (më pak i efektshëm) në A (më i efektshëm).

5) Ky program për larjen e enëve është cikli standard i pastrimit për të përpiluar informacionet e klasifikimit të energjisë. Është bërë për larjen e enëve të ndotura normalisht dhe është programi më i efektshëm për sa i përket konsumit të energjisë dhe ujit të kombinuar së bashku.

Të dhëna teknike

Lartësia:	817-867 mm
Gjerësia:	596 mm
Thellësia:	577 mm
Pesha:	35 kg ¹⁾
Presioni i ujit:	0.03–1.0 MPa
Lidhja elektrike:	Shikoni etiketën e numrit të serisë
Energjia nominale:	Shikoni etiketën e numrit të serisë

1) Pesha mund të ndryshojë për shkak të specifikimeve të ndryshme.